



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	
Institucioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution	
Nr./Br./No.	96012017
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.	20106117
Data/Datum/Date:	
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA	



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

## RAPORT ME REKOMANDIME

**A. nr. 597/2014**

**ĐORĐE ARTINOVIC**

**Lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën  
Themelore në Prishtinë**

Për: **Znj. Afërdita Bytyçi, Kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë**

**Z. Nehat Idrizi, Kryesues  
Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

Prishtinë, 20 qershor 2017

## **VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT**

- 1 Më 23 dhjetor 2014, Đorđe Artinović (në tekstin e mëtejmë „ankuesi“), e paraqiti ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejmë: IAP), që ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, për të konfirmuar të drejtat e pronësisë dhe posedimit të pronës së paluajtshme, e cila është usurpuar në mënyrë të paligjshme nga ana e palëve të treta (në tekstin e mëtejmë "të paditurit"). Ankuesi ka iniciuar padinë në, asokohe Gjykata Komunale, kurse tani Gjykata Themelore në Prishtinë, më 14 korrik 2008 (C.nr.1383/08), për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore.
- 2 Më 29 dhjetor 2014, ankesa është regjistruar në IAP (nr.i ankesësë 597/2014).
- 3 Më 21 janar 2015 këshilltarja ligjore e IAP bisedoi me gjyqtarin e degës së Gjykatës Themelore në Graçanicë dhe kërkoi informacion në lidhje me procedurat e ndërmarrë dhe/ose të planifikuara me qëllim që rasti të zgjidhet brenda një kohe të arsyeshme. Këshilltarja ligjore e IAP është informuar se, për shkak të mungesës së gjyqtarëve në degën e kësaj gjykate në Graçanicë gjatë vitit 2014, lënda e ankuesit është transferuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- 4 Më 6 shkurt 2015, Avokati i Popullit iu drejtua me shkresë kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën kërkoi të informohej lidhur me fazën në cilën ndodhej kjo lëndë në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- 5 Më 19 shkurt 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën ai e informonte Avokatin e Popullit se lënda e ankuesit fillimisht është procesuar në degën e Gjykatës Themelore në Graçanicë, ku ka marrë numrin përkatës. Më 29 shtator 2011 është mbajtur një seancë paraprake dhe është nxjerrë një aktvendim, sipas të cilit duhet të bëhet një ekspertizë nga ana e një eksperti në fushën e gjeodezisë me qëllim të identifikimit dhe përcaktimit të ngastrave që janë objekt i lëndës. Vonesa në shqyrtimin e rastit të ankuesit, siç thuhet në letër, ishte për shkak të mungesës së gjyqtarëve në degën e kësaj gjykate në Graçanicë dhe për shkak se gjykata është e mbingarkuar me numër të madh të rasteve me prioritet. Në këtë drejtim, deri më tani ka qenë e pamundur të vendoset në rastin e ankuesit, si dhe rastet e ngjashme për shkak të arsyses së cekur. Në përgjigje më tej thuhet, se lënda e ankuesit, më 28 maj 2013, së bashku me një numër të caktuar të lëndëve të tjera është transferuar nga Dega e Gjykatës Themelore në Graçanicë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me qëllim që më vonë t'i ndahej gjyqtarit për procedim. Më 12 shkurt 2015, gjyqtari i lëndës ia dërgoi Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë AKP) në Prishtinë një kërkësë për dhënien e të dhënavë lidhur me pronën lëndore dhe pas marrjes së përgjigjes nga AKP-ja, siç thuhet në letër do të vazhdohet me procedimin e lëndës.
- 6 Më 2 qershor 2015, Avokati i Popullit i dërgoi letrën e dytë kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën kërkoi të informohej lidhur me atë se në cilën fazë të procedurës gjendet kjo lëndë në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- 7 Më 17 qershor 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në të cilën thuhet se lidhur me lëndën e ankuesit është caktuar një seancë gjyqësore për datën 7 maj 2015, por gjyqtari i lëndës e ka shtyrë seancën për shkak të mungessës së ankuesit dhe përfaqësuesit të tij. Bashkë me letër Avokatit të Popullit i është bashkëngjitur edhe fletëdërgesa e dorëzimit personal të ftesës për seancën e caktuar, e cila është nënshkruar në mënyrë të rregullt më 17 prill 2015, nga ana e një avokati të autorizuar në bazë të autorizimit të ankuesit.

- 8 Më 7 gusht 2016, këshilltarja ligjore e IAP i dërgoi një e-mail gjyqtarit të lëndës dhe e informoi që sipas pohimeve të ankuesit, ai nuk ka qenë fare i informuar për seancën e caktuar. Gjyqtari i lëndës gjithashtu u informua, se më 2 korrik 2015, ankuesi e revokoi autorizimin, të cilin ia kishte dhënë avokatit, e dorëzoi parashtresën në fjalë në Gjykatë dhe kërkoi që në të ardhmen të ftohen personalisht që të marrë pjesë në seancat e caktuara gjyqësore.
- 9 Më 23 tetor 2015, Avokati i Popullit ia dërgoi kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë letrën e tretë, në të cilën konstatoi se nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh konkrete me qëllim që çështja të zgjidhet brenda një kohe të arsyeshme, veçanërisht nëse merret parasysh fakti se kontesti pronësor po zgjat më shumë se tetë vjet. Avokati i Popullit kërkoi me atë rast që t'i dërgohen informata lidhur me atë, se në cilën fazë të procedurës gjendet lënda e ankuesit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- 10 Më 19 nëntor 2015, këshilltarja ligjore e IAP në takimin e mbajtur me gjyqtarin e lëndës në Gjykatën Themelore në Prishtinë u informua për datën e caktuar të seancës gjyqësore të radhës për lëndën e ankuesit. Përveç kësaj, këshilltarja ligjore e IAP theksoi se gjatë korrespondencës së fundit me shkrim, Avokati i Popullit e informoi Gjykatën për revokimin e autorizimit të avokatit të ankuesit. Lidhur me këtë, gjyqtari i procedurës paraprake deklaroi se në të ardhmen do ta dërgojë ftesën në adresën e ankuesit në Graçanicë. Këshilltarja ligjore gjithashtu bisedoi me gjyqtarin e lëndës për procedurat e ndërmarra dhe të planifikuara, si dhe për lutjen e ankuesit që të bëhet një espertizë nga ana e një eksperti në fushën e gjeodezisë me qëllim të identifikimit të ngastrave katastrale që janë objekt i lëndës, meqë me aktvendimin e vitit 2013 është dhënë urdhri për t'u bërë ekspertiza, por i padituri nuk ka lejuar qasje në pronën e kontestuar.
- 11 Më 1 dhjetor 2015 ankuesi e ka informuar këshilltaren ligjore të IAP, se në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seancë lidhur me lëndën e tij dhe gjyqtari i lëndës ka lëshuar një urdhër që eksperti i shërbimit të gjeodezisë të bëjë hetimin në vendin e ngjarjes, më 12 dhjetor 2015, me qëllim të identifikimit të ngastrës kadastrale.
- 12 Më 11 janar 2016, këshilltarja ligjore e IAP është informuar nga ankuesi se ekspertiza e shërbimit të gjeodezisë është shtyrë për datën 12 janar 2016.
- 13 Më 9 mars 2016, ankuesi e informoi këshilltaren ligjore se ekspertiza e caktuar më parë nuk është e mbajtur. Sipas pohimeve dhe njohurive të ankuesit, eksperti i shërbimeve gjeodezike i caktuar me udhër të gjykatës e konstatoi se për arsyet e sigurisë nuk mund ta realizojë inspektimin. Ankuesi nuk ka asnjë informacion tjeter për veprimet e ndërmarra në këtë rast.
- 14 Avokati i Popullit pas kësaj ia dërgoi dy letra Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 12 prill dhe 18 maj, duke kërkuar urgjencë në zgjidhjen e kësaj çështjeje në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Mirëpo, në korrespondencën në fjalë nuk mori përgjigje.
- 15 Në bazë të korrespondencës me shkrim ndërmjet IAP dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 21 qershori 2016 dhe 13 korrik 2016, Avokati i Popullit u informua se, në bazë të urdhrit të gjyqtarit për ekspertizë, e cila është dashur të bëhet më 12 janar 2016, eksperti i gjeodezisë e ka informuar gjykatën, më 8 janar 2016, për pengesën e përkohshme që është paraqitur në kryerjen e ekspertizës, për shkak se gjendet jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Në letër më tej thuhet, se më 25 janar 2016, gjykata i ka kërkuar zyrtarisht nga Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe pronë e Komunës së Prishtinës të gjitha informatat në dispozicion në lidhje me pronën e paluajtshme të kontestuar, të cilat i janë dërguar gjykatës më 1 shkurt 2016. Gjyqtari i procedurës, në

letër gjithashtu theksoi se është në zhvillim e sipër caktimi i ekspertizës së radhës për dalje në terren, për çka palët do të informohen me kohë. Përveç kësaj, është theksuar se gjykata udhëhiqet nga parimet e punës në lëndët me prioritet dhe se gjyqtari i lëndës është i mbingarkuar numër të madh të lëndëve, prandaj të njëjtat nuk është e mundur të zgjidhen brenda një kohe të arsyeshme.

## PËRMBLEDHJA E FAKTEVE NË RAST

Faktet që janë konstatuar deri tani mund të paraqiten si më poshtë:

- 16 Ankuesi është bashkë-pronar në 1/3 e pjesëve ideale të patundshmërinë në Prishtinë, në lagjen Kodra e Trimave p.n., e cila nuk është e ndarë fizikisht dhe përbëhet nga parcelat P 71914059-00077-1, me sipërfaqe prej 3006 m<sup>2</sup> dhe parcelës P71914059-2 me sipërfaqe prej 1420 m<sup>2</sup>. Këto patundshmëri, sipas pohimeve të ankuesit, të paditurit i kishin uzurpuar ilegalisht pas qershorit të vitit 1999.
- 17 Më 14 korrik 2008, ankuesi ngrit padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë për të konfirmuar të drejtën e pronësisë dhe posedimit të pronës së paluajtshme (P.br.1383 / 08).
- 18 Pas dorëzimit të padisë së ankuesit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, më 29 shtator 2011 është mbajtur një seancë përgatitore dhe gjyqtari i lëndës lëshoi një urdhër që të caktohet një ekspert nga fusha e gjeodezisë, me qëllim të identifikimit dhe përcaktimit të ngastrave që janë objekt i lëndës. Mirëpo që nga ajo datë nuk ka pasur ndonjë lëvizje në lëndën e ankuesit.
- 19 Më 28 maj 2013, lënda e ankuesit C.nr.1383/08 është transferuar nga dega e Gjykatës Themelore në Graçanicë në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- 20 Më 17 dhjetor 2014, ankuesi ia paraqiti Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Prishtinës, kërkesën nr. 011-095-279519 për konfirmimin e kufirit të patundshmërisë së kontestuar.
- 21 Më 23 dhjetor 2014, Drjetoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Prishtinës ia dërgoi ankuesit një njoftim, në të cilin thuhet se ekspertët e Drejtorisë dolën në terren dhe u konstatua se në ngastrat e kontestuara kadastrale janë ndërtuar shtëpi, shfrytëzuesit e të cilave kanë deklaruar se atë pronë e kanë blerë para 45 vjetësh dhe që nga ajo kohë ata jetojnë në të njëjtën pronë.
- 22 Pas shumë intervenimeve drejtuar kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë nga ankuesi, nuk është vazhduar më procedimi i mëtejmë i lëndës së tij.
- 23 Më 23 dhjetor 2014, ankuesi paraqiti ankesë në IAP për shkak të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kur u pranua ankesa dhe u evidentua me numrin 597/2014.
- 24 Më 12 shkurt 2015, pasi rasti i ankuesit u nda për procedim, gjyqtari i procedurës i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërmori hapa të caktuar procedural, përkatësisht i dërgoi AKP-së në Prishtinë një kërkesë për dhënien e informacionit në lidhje me pronën që është objekt i lëndës.
- 25 Më 17 qershor 2015 këshilltarja ligjore e IAP e informoi ankuesin lidhur me letrën, e cila i është dërguar Avokatit të Popullit nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në të cilën thuhet se më 7 maj 2015, gjykata e ka shtyrë seancën për shkak të mungesës së ankuesit.

- 26 Më 2 qershor 2015, ankuesi e revokoi autorizimin, të cilin ua kishte dhënë avokatëve, për shkak se të njëjtë nuk e kishin informuar për datën e seancës së caktuar gjyqësore, as nuk kishin marrë pjesë në seancën dëgjimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- 27 Më 26 nëntor 2015 në seancën e caktuar gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjyqtari i procedurës lëshoi një urdhër që eksperti i shërbimit të gjeodezisë të bëjë inspektimin në vendin e ngjarjes me qëllim të identifikimit të ngastrave kontestuese kadastrale.
- 28 Më 8 janar 2016 eksperti i gjeodezisë e informoi gjykatën se është i penguar përkohësisht për ta kryer ekspertizën, për shkak se gjendet jashtë territorit të Republikës së Kosovës
- 29 Më 25 janar 2016 Gjykata Themelore kërkoi zyrtarisht nga Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe pronë e Komunës së Prishtinës të gjitha informatat në dispozicion në lidhje me pronën e paluajtshme të kontestuar, të cilat i janë dërguar Gjykatës më 1 shkurt 2016.
- 30 Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk nxorri kurrrfar vendimi lidhur me lëndën e ankuesit C.nr. 1383/08.

### **INSTRUMENTET RELEVANTE**

- 31 Ligji për procedurën kontestimore nr.03/L-006 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03-L-006 për procedurën kontestimore br.04/L-118 (në tekstin e mëtejmë "Ligji për procedurën kontestimore") në nenin 10 thotë:
- "Gjykata ka për detyrë të përpinqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji."*
- 32 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më tej "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut" ose "Konventa"), është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse nisi 22.2 i Kushtetutës garanton të drejtën e aplikimit të drejtëpërdrejtë të Konventës dhe Protokolleve që me Kushtetutën e Republikës së Kosovës u është garantuar të gjithë qytetarëve të saj.
- 33 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (4 nëntor 1950) në nenin 6, paragrafin 1 thotë:
- "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...]."*
- 34 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 13 thotë:
- "Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbrushje të funksioneve të tyre zyrtare."*

### **ANALIZA**

#### **E drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

32. Ankuesi ankohet në kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ai ankohet se është duke pritur aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore pothuajse 8 vjet, dhe se kjo paraqet shkelje të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë:

*“Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...].”*

33. I njëjtë parim gjendet në nenin 10 të Ligjit për procedurën kontestimore, i cili thotë:

*“Gjykata ka për detyrë të përpinqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje [...].”*

34. Në fillim, Avokati i Popullit vë në dukje se kontestet civile për përcaktimin e të drejtave të pronësisë dhe posedimit të pronës së paluajtshme, konsiderohen të drejta qytetare në kuptim të nenit 6 të Konventës, i cili për këtë arsyе është i zbatueshëm në procedurën e këtij rasti.

35. Avokati i Popullit rikujton se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane konstatoi se në rastin që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave zakonisht llogaritet nga koha e fillimit të procedurave gjyqësore (shih shembullin, Sienkiewicz kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 30 shtator 2003) deri në kohën kur rasti përfundimisht vendoset dhe/ose aktgjykimi përmbarohet (shih Vocaturo kundër Italisë (II) aktgjykimin e datës 24 maj 1991).

36. Avokati i Popullit vë në dukje se procedurat e filluara në tërësi në atëherë Gjykata Komunale, kurse tani Gjykata Themelore në Prishtinë më 14 korrik 2008, kur është ngritur padia kundër të paditurit vazhdojnë sot e kësaj dite. Për këtë arsyë, procedurat zgjasin pothuajse 8 vjet në shkallën e parë.

37. Avokati i Popullit rikujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet nën dritën e rrëthanave të veçanta të çështjes dhe duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara me praktikën gjyqësore, sidomos kur është në pyetje kompleksiteti i rastit, sjellja e palëve dhe autoritetetve që punojnë në këtë rast, si dhe ajo çfarë është në interesat e ankuesit (shih rastin Gollner kundër Austrisë, aktgjykimi idatës 17 janar 2002).

38. Avokati i Popullit vuri në dukje se rasti i ankuesit nuk ishte i ndërlikuar dhe sjellja e ankuesit nuk kishte kontribuar në asnjë vonesë.

39. Sa i përket procedurave të organeve gjyqësore, Avokati i Popullit konstaton se sipas përgjigjes nga Gjykata Themelore në Prishtinë, vonesa në shqyrtimin e rastit të ankuesit ndodhi për shkak të mungesës së gjyqtarëve dhe për shkak se gjykata është e mbingarkuar me numër të madh të rasteve me prioritet. Gjykata Themelore në Prishtinë në letrën e vet ka deklaruar gjithashtu se deri më tani ka qenë e pamundur të vendoset në rastin e ankuesit, si dhe rastet e ngashme (shih paragrafin 5 më sipër).

40. Avokati i Popullit rikujton se në rastin e lartëpërmendur Vocaturo kundër Italisë, qeveria italiane deklaroit se arsyja për vonesën në procedurë ishte numri i madh i rasteve në gjykata. Në këtë rast, Gjykata konsideron se neni 6, paragrafi 1 ua imponon shteteve detyrimin që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që gjykatat t'i përbushin kërkeshat e Konventës. Megjithatë, grumbullimi i përkohshëm i lëndëve të pazgjidhura nuk përfshin përgjegjësinë e shteteve, me kusht që të ndërmerren masa me kohë dhe të merren me situatën e kësaj natyre (shih Milasi kundër Italisë, aktgjykimi i datës 25 qershori 1987. Shih po ashtu edhe Foti dhe të tjerët kundër Italisë, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 1982).

41. Edhe nëse marrim parasysh faktin se gjyqësori ka problem me numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura për shkak të mungesës së gjyqtarëve, gjykatat kompetente ende e kanë obligim të sigurojnë drejtësi me kohë. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit rikujton që neni 10 i Ligjit për procedurën kontestimore, thotë se gjykata “... ka për detyrë të përpinqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje të panevojshme[...].”

42. Në periudhën prej 29 shtator 2011, kur është mbajtur seanca paraprake dhe është nxjerrë një urdhër i gjykatës që të bëhet një ekspertizë nga ana e një eksperti në fushën e gjeodezisë me qëllim të identifikimit dhe përcaktimit të ngastrave që janë objekt i lëndës, deri në ditën e sotme, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka ndërmarrë masa konkrete lidhur me lëndën e ankuesit. Prandaj, ajo as nuk e ka trajtuar rastin me kujdesin e duhur, siç kërkohet në nenin 6, paragrafin 1 të Konventës dhe nenin 10 të Ligjit të Procedurës kontestimore. Lënda në Gjykaten Themelore në Prishtinë nuk ka qenë e ndërlikuar dhe ka mund të zgjidhet lehtë pa pasur nevojë që të sigurohen prova shtesë, të mbahen seanca dëgjimore ose të ndërmerren veprime të tjera që mund të kontribuonin në një vonesë të ligjshme në shqyrtimin e çështjes. Për më tepër, Avokati i Popullit vë në dukje se rasti ishte i një rëndësie të veçantë për ankuesin, i cili jeton si person i zhvendosur dhe të ardhurat e vetme të të cilit janë pensioni, i cili mezi mjafton që të mbulohen nevojat e tij themelore.
43. Në dritën e asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit konsideron që dështimi i autoriteteve të rekrutojnë numrin adekuat të gjyqtarëve (shih më lart paragrafët 5 dhe 13), të cilët do të merreshin me vëllimin e punës, nuk mund të konsiderohet arsyetim i vlefshëm për vonesa të tilla në Gjykaten Themelore në Prishtinë. Avokati i Popullit vëren që kjo është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të garantojnë me kohë ndarjen e kontesteve civile përmes emërimit të numrit adekuat të numrit të gjyqtarëve, ose përmes mjeteve të tjera përkatëse.

### Konstatimet e Avokatit të Popullit

44. Avokati i Popullit konstaton se për këtë shkak ka ardhur deri te shkelja e të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### E drejta për zgjidhje efektive: Neni 13 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut

45. Ankuesi parashtroi ankesë në mungesën e një mjeti efektiv në kuptim të shkeljes të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që përbën shkelje të të drejtës së tij për një zgjidhje efektive sipas nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

*„Cdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare“.*

46. Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut disa herë ka theksuar që vonesat e tepërtë në administrimin e drejtësisë në aspektin, kur pala nuk ka kurrfarë mjeti ligjor në dispozicion, përbën kërcënëm të sundimit të ligjit brenda sistemit juridik vendor (shih, për shembull, Bottazzi kunder Italsë, aktgjykimi i 28 korrikut 1999 dhe Di Mauro kundër Italisë aktgjykimi i 28 korrikut 1999.). Avokati i Popullit rikujton gjithashtu se ndonëse Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsideron se kërkesat për një mjet efektiv ligjor duhet të interpretohen në kuptimin që mjeti juridik mund të jetë efektiv në aspektin e fushëveprimit të kufizuar të kërkimit të ndihmës thelbësore në kontekstin e caktuar (*Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë aktgjykimi i 6 shtatorit të vitit 1978.*), e njëjta ka konsideruar si vijon:

*„Lidhur me dështimin e cekur që të sigurohet gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor [...] asnjë kualifikim thelbësor brenda fushëveprimit të nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, të parapara në Konventë do të diskutoheshin në favor të kufizimeve të*

*theksuara të nenit 13 dhe do të mbaheshin minimalisht. (Kudla kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 26 tetor 2000.). "*

47. Neni 13 pasqyrohet drejtpërdrejt në detyrimin e shteteve që përmes sistemeve të veta gjyqësore t'i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe në këtë mënyrë t'i krijojnë garanci shtesë individit, gjë që do t'i siguronte atij ose asaj që këto të drejta t'i gjëzojë në mënyrë efikase. Shikuar nga kjo perspektivë, e drejta e një personi për gjykim brenda një kohe të arsyeshme kohore do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston asnjë mundësi që të paraqitet një ankesë te autoritet shtetërore. Dispozitat e nenit 13 i përforcojnë ato të nenit 6 (shih aktgjykimin e lartpërmendor Kudla). Për këtë arsyen 13 garanton një mjet ankimi efikas para autoriteteve kombëtare për shkeljen e pretenduar të dispozitave të nenit 6, përfundimin e çështjes brenda një kohe të arsyeshme. Meqë ky rast ka të bëjë me një ankesë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, nenit 13 i Konventës është i zbatueshëm.
48. Në kuptim të dispozitave të nenit 13 të Konventës Evropiane, Avokati i Popullit rikujoin se efekti i këtij neni është që të kërkojë sigurimin e një mjeti ligjor vendor që të merret me çështjen e "ankesës kontestuese" sipas Konventës dhe të japë kompensimin e duhur finansiar (*Kaya kundër Turqisë*, aktgjykimi i 19 shkurtit 1998.). Çdo mjeti i tillë juridik duhet të jetë efektiv në praktikë dhe në ligj (*Ilhan kundër Turqisë* aktgjykimi i 27 qershorit 2000.). Në lidhje me ankesën në kohëzgjatjen e procedurës, Avokati i Popullit rikujoin që "mjeti ligjor efektiv" në kuptim të nenit 13 të Konventës duhet të jetë në gjendje ta parandalojë shkeljen e pretenduar, ose vazhdimin e të njëjtës, ose sigurimin e kompensimit adekuat për çfarëdo shkelje që ka ndodhur tashmë (shih aktgjykimin e lartpërmendor Kudla).
49. Avokati i Popullit vëren se nuk ekziston asnjë qasje ligjore, përmes së cilës ankuesi në rastin konkret ka mund të ankohej për zvarritjen e procedurës me mundësi të realizimit të ndihmës parandaluese apo kompensuese.

## **REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT**

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, paragrafi 4 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon :

### ***Gjykatën Themelore në Prishtinë***

- Duke pasur parasysh vonesat e mëhershme, të ndërmerrën veprime në drejtim të shqyrimit dhe vendosjes në lëndën e ankuesit pa vonesa të mëtejme.***

### ***Këshillin Gjyqësor të Kosovës***

- Të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbente mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formën e parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj") dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të

përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.



Me nderime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit